



| | | | |
|--|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planina / Detyrimi Prilloga / Profili Received / Delivered | 25. 11. 2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr Prot Br. Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKINSHTICK | 5682/2021 | | 1/3 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.880/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.35/20 të datës 19.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativë, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.661/2019 të datës 28.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Luan Haradinaj", Zyra 204, Kati III në ndërtesën e Agjencisë së Regjistrimit Civil, kundër organit të punësimit Agjencisë së Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar ma ankesën me numër A.nr.661/2019 të datës 28.10.2019 të parashtruar nga ankuesi për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit me datë 16.10.2019 Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i ka shqiptuar masë disiplinore, "*Vërejtje me shkrim*".

Ankuesi i pakënaqur me masën e shqiptuar të datës 16.10.2019, ka parashtruar ankesë me datë 28.10.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër 5069/2019, me pretendimet ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 04.11.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Agjencia e Regjistrimit Civil. Me datë 12.11.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Regjistrimit Civil, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 10.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për

Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 19.10.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.35/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll 5070/219 të datës 28.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 22.05.2019 të ankuesit; Emailin e datës 24.05.2019 të për ankuesin; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 18.06.2019, 14.06.2019; Emailin e datës 29.05.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 29.05.2019 nga ankuesi; Emailin e datës 04.04.2019, 30.05.2019, 10.05.2019, 20.09.2019; Njoftimin e datës 08.10.2019; Konkursin për Udhëheqës të Qendrës për Pajisje me Dokumente në Prishtinë; Përshkrimin e detyrave të punës Udhëheqës të Qendrës për Pajisje me Dokumente; Vërejtje me shkrim e datës 16.10.2019 për ankuesin; Emailin e datës 11.10.2019 nga për Emailin e datës 11.10.2019 nga për Emailin e datës 08.10.2019 nga për Emailin e datës 04.10.2019 nga për Emailin e datës 25.09.2019 nga ankuesi; Vendimin e datës 24.09.2019; Emailin e datës 11.09.2019 dhe 10.09.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 09.09.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 09.09.2019 nga ankuesi për Emailin e datës 03.09.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 12.05.2019, 14.05.2019, 12.04.2019, 25.04.2019, 07.03.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 10.05.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 18.12.2018 nga ankuesi për Emailin e datës 18.12.2018 dhe 21.12.2018 nga për ankuesin; Emailin e datës 19.12.2018 nga ankuesi për Emailin e datës 19.12.2018 dhe 18.12.2018 nga Emailin e datës 19.12.2018 nga për ankuesin; Emailin e datës 19.12.2018 nga Emailin e datës 18.12.2018 nga ankuesi; Emailin e datës 13.02.2018 nga Emailin e datës 09.02.2018 nga Emailin e datës 08.02.2018 nga Emailin e datës 21.02.2019 nga për ankuesin; Emailin e datës 07.02.2019 nga ankuesi për Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.11.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 12.11.2019; Njoftimin e datës 10.12.2019 Aktgjykimin A.nr.35/20 i datës 19.10.2021; Kërkesën për informata zyrtare e datës 23.11.2021 dhe përgjigjen e datës 24.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bërë i pamundur, sepse:**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ka pranuar Aktgjykimin A.nr.35/20 të datës 19.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me qëllim të vendosjes në mënyrë sa më meritorë për rastin e ankuesit, më datë 23.11.2021 kemi kërkuar informata zyrtare nga Zyra e Burimeve Njerëzori e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nëse **është hequr masa disiplinore vërejtje nga dosja personale e ankuesit.**

Zyra e Burimeve Njerëzori e Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 24.11.2021, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se **Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB – së, komfor nenit 51, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenit 14, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) NR. 11/2021 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë, ka shuar masën disiplinore e z. Thaçi, të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil/MPB, duke e fshirë nga dosja personale e z. Thaçi.**



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ndaj ankuesit është shuar masa disiplinore “vërejtje me shkrim” siç parashihet edhe me dispozitat e nenit 51 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 14, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) NR. 11/2021 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, atëherë çdo vendim tjetër nuk do të kishte efekt juridik, meqë ankuesi nga momenti kur i është shuar masa disiplinore konsiderohet sikurse nuk ka pas asnjëherë masë disiplinore.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kohë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kështu në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 28.10.2019 të ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.880/2021

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së